

GAZETA DITORE



GAZETARËT NË NJË VEND DEMOKRATIK

DAFINA (13), DENISA (13), AVNI (14), LENDRIT (14), HEROLIND (13), ARBENIT (15)



Zhvillimi i demokracisë në periudha të ndryshme kohore

Demokracia është sistem i qeverisjes ku populli e ka fjalën kryesore dhe ka të drejtat dhe liritë e veta. Demokracia për herë të parë është paraqitur në Greqinë e lashtë në vitin 507 p.e.s. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja, ku “demos” do të thotë popull dhe “kratia” do të thotë pushtet. Pra, demokraci do të thotë pushtet i popullit. Demokracia atëherë nuk ka qenë sikur sot, sepse kur ka filluar në Greqi, në vendimmarrje kanë pasur të drejtë të marrin pjesë vetëm burrat e pasur, kurse nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë gratë dhe njerëzit e varfër. Demokracia nga e kaluara ka ndryshuar shumë, sepse ajo sot është shumë e zhvilluar. Pse sot demokracia është e zhvilluar? Demokracia sot është shumë e zhvilluar sepse kemi shumë më shumë të drejta, liri dhe barazi. Të drejtat themelore të njeriut janë: e drejta për jetë, e drejta për të pasur një familje, e drejta për punësim, për shkollim, për argëtim etj. E

drejta e shkollimit dhe e punësimit kanë shumë lidhje me njëra-tjetrën. Neve, shteti ynë na krijon kushte për shkollim duke na siguruar shkollën, librat, bankat shkollore etj. Ne, kur të rritemi dhe të punësohemi secili në profesionet tona si ushtarë, futbollistë, doktorë, fotografë, edukatorë, agjentë turizimi etj., do të mendohejmë që me punë t'ia kthejmë këto të mira shtetit tonë demokratik. Demokracia ndahet në dy forma: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli merr pjesë në vendime politike në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur vendimet politike merren nga përfaqësuesit e popullit, të zgjedhur nga vet populli. Demokracia përfaqësuese ndahet në demokracinë përfaqësuese parlamentare dhe demokracinë përfaqësuese presidenciale. Republika e Kosovës ka demokraci përfaqësuese parlamentare. Ne jemi të kënaqur që kemi këtë formë të demokracisë në shtetin tonë, Kosovën.



Gazetarët gjatë përgatitjes së artikullit



Gazetarët e rinj

ZGJEDHJET NË KOSOVËN TONË

OLTA (13), DIELLZA (13), KRENAR (13), ALAUDIN (13), KUJTIM (14)



Ne si fëmijë të Kosovës, sot në punëtorinë e demokracisë morëm rolin e gazetarëve. Në këtë artikull ju mund të lexoni mbi idetë tona rreth demokracisë dhe zgjedhjeve në Kosovë


Këtë artikull po e fillojmë duke iu treguar disa fakte mbi demokracinë. Demokracia është formë e qeverisjes së një populli. Ajo ka lindur në Athinë të Greqisë, në vitin 507 p.e.s. Forma e parë e demokracisë ishte demokracia e drejtpërdrejtë. Fjala „demos“ d.m.th. popull, kurse „kratos“ d.m.th. qeverisje. Forma e dytë e demokracisë është demokracia përfaqësuese. Kjo demokraci lindi në shtetet demokratike, të cilat kishin nevojë për disa përfaqësues që do t'i përfaqësonin të gjithë qytetarët e një vendi. Edhe shteti ynë Kosova udhëhiqet përmes demokracisë përfaqësuese. Kjo do të thotë se ne, qytetarët e saj votojmë për përfaqësuesit tanë. Procesi kur ne dalim dhe votojmë quhet zgjedhje. Në Kosovë ka dy lloje zgjedhjesh. Ato janë zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore.

Në zgjedhjet komunale zgjedhet kryetari i komunës si p.sh. i Prishtinës. Ndërsa, në zgjedhjet parlamentare qytetarët e Kosovës zgjedhin deputetët të cilët do të punojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi ka 120 deputetë të ndarë në pozitë dhe opozitë. Pozita është partia e cila në zgjedhjet e fundit ka marrë më shumë vota, kurse opozita është partia e cila ka fituar më pak vota. Në këto zgjedhje votohet me dorë dhe me letër, ku në atë letër paraqiten emrat e kandidatëve. Kandidati, i cili na pëlqen më shumë për atë detyrë e shënojmë me simbolin e votës. Qytetarët të cilët dëshirojnë të votojnë duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare, sepse personat në këtë moshë kanë më shumë përvojë dhe mund të marrin vendime më të mira.

Ne si fëmijë nuk marrim pjesë në këto zgjedhje, mirëpo ne bëjmë zgjedhje të përditshme si, p.sh. zgjedhim librat të cilët duam t'i lexojmë etj. Prandaj, zgjedhjet janë aq të rëndësishme për ne.



Autorët e artikullit



Kjo është një përmbledhje mbi zgjedhjet

MËNYRA E NDARJES SË PUSHTETIT

ALMA (13), ALBINA (14), FATBARDH (13), ARITA (13), VERONA (13), ARZANA (14)

Pushteti ndahet në mënyrë korrekte dhe të barabartë për tri institucionet

Ne si shoqëri e civilizuar, ndarjen e pushtetit e bëjmë në mënyrë që të gjithë të jemi të barabartë me njëri-tjetrin, të mos kemi diskriminime në shoqëri dhe që ta kryejmë punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Në Republikën e Kosovës ndarja e pushtetit bëhet në tri pjesë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësorë.

Pushteti Legjislativ bën ligjet dhe deputetët i votojnë ato ligje nëse janë të mira dhe nëse janë në favor të qytetarëve. Në Kuvendin e Kosovës gjithsej janë 120 deputetë, nën udhëheqjen e Kryetarit të Kuvendit. Aty gjithashtu punojnë edhe zëvendëskryetari si dhe punëtorë të tjerë të cilët kryejnë funksione të ndryshme administrative. Pasi që gjinia mashkullore


dhe gjinia femrore kanë të drejta barabarta, në Kuvend punojnë edhe gratë edhe burrat, që do të thotë se nuk ka dallime gjinore në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne qytetarët e Kosovës i votojmë deputetët si përfaqësuesit tonë, ndërsa këta përfaqësues e kanë të drejtën ta zgjedhin Presidentin e vendit me vota. Këto vota i kontrollojnë komisionet e Kuvendit dhe në fund e zgjedhin atë që ka më shumë vota. Pra, Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare dhe përfaqësuesit tonë janë deputetët. Nëse ne si qytetarë shprehim pakënaqësi për mënyrën se si përfaqësohemi, atëherë mund të organizojmë protesta paqësore të cilat janë të pranuar edhe me Kushtetutë.



Ndarja e punëve në grupe



Funksioni përfaqësues i Kuvendit




Ilustrim i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Ne jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si punët duhet të ndahen dhe se duhet ta respektojmë punën e të tjerëve

Pushteti tjetër është pushteti Ekzekutiv, i cili ushtrohet nga Qeveria e Kosovës. Në krye të Qeverisë është kryeministri, pastaj janë ministrat e ndryshëm të cilët udhëheqin ministritë përkatëse. Disa nga ministritë në Kosovë janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Diasporës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale etj.

Të gjitha këto ministri punojnë brenda Qeverisë dhe ato bashkëpunojnë njëra me tjetrën gjatë gjithë kohës. Qeveria është ajo e cila i jep llogari Kuvendit të Kosovës, sepse ajo zgjedhet nga deputetët dhe Kuvendi e posedon të drejtën ta kontrolloj punën që e bën Qeveria dhe personat të cilët punojnë në këtë institucion.




Institucioni i Qeverisë

Në Kosovë ekziston edhe pushteti gjyqësor i cili përbëhet nga gjykatat. Këto gjykata ndahen në: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit si dhe Gjykata Supreme.


Qëllimi i këtyre gjykatave është të vendosin drejtësi në vend, duke gjykuar përmes provave të gjithë qytetarët për të cilët dyshohet se kanë shkelur ligjin. Ne si qytetarë jemi të obliguar t'i respektojmë dhe zbatojmë ligjet të cilat kanë dalur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjithashtu këto ligje nuk duhet të zbatohen vetëm prej neve, por edhe prej vetë përfaqësuesve të shtetit, të cilët edhe konsiderohen të jenë si shembuj për ne qytetarët e Republikës së Kosovës.



Institucioni i Gjykatës Supreme



Ndarja e Pushtetit



Funksionet e Kuvendit të Kosovës



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë